

TRAJTIMI I UJIT



UJI

Secili nga ne ka përgjegjësi për ujin, pasi të gjithë jemi përdorues të tij, pra të gjithë duhet ta mbrojmë dhe ta ruajmë atë nga ndotja. Uji është një pjesë përbërëse e sipërfaqes së Tokës. Sasia e madhe e ujit është ajo që na bën ta quajmë Tokën “Planeti i kaltër”. Gjithsesi, pjesa kolosale e rezervave të ujit u përket oqeanëve dhe deteve dhe vetëm 0,6% e sasisë së përgjithshme të ujërave është e përshtatshme për t’u pirë. Ujërat sipërfaqësor dhe ata nëntokësor janë elemente të rëndësishme në ciklin e ujit në tokë.

Uji përdoret për qëllime bujqësore (ujitje), për qëllime industriale (prodhimi i të mirave materiale dhe si faktor për ngrohje, ftohje), për qëllime shtëpiake (pirje, higjiena personale, larje dhe për çlodhje). Në ditët e sotme probleme serioze paraqet përdorimi pa kriter i ujit, si dhe rritja e ndotjes së burimeve të ujit, gjë që mund të çojë mbarë njerëzimin në një katastrofë. Meqenëse të gjithë jemi përdorues të ujit, ne jemi në të njëjtën kohë, edhe përgjegjës për mbrojtjen e tij. Dy parimet bazë për mirëmbajtjen e burimeve ujore janë ruajtja dhe mbrojtja.



Trajtimi i ujit behet nepermjet disa proceseve:

1-Procesi i pastrimit mekanik. Eshte nje proces i cili realizon eleminimin e thermijave dhe te pjesezave te lendve te ngurta te cilat kane madhesi me te madhe se 10 mm. Kjo realizohet nepermjet vendosjes te sitave ose shoshave njera mbi tjetren. Prej kesaj ujrat nepermjet presionit kalojne nepermjet hinkave fund i te cilave ,eshte shume i ngushte dhe per pasoje ne te ngelin te gjitha pezullit ose lendet e ngurta .



2. Procesi i pastrimit kimik. Kimikatit per pastrimin kimik i shtohet llumbi aktiv. Elementi qe i shtohet ujit ne kete rast eshte uji dhe hekuri te cilet sherbejne si agjente precipitimi per bakteret ocardium.

3. Procesi i pastrimit biologjik. Metodologjia e trajtimit bjologjik ka te beje me largimin e perbersve organik nepermjet oksidimit biologjik.

4. Procesi i koagulimit. Eshte procesi i destabilizimit te thermijave koloidale ne susbension.



5. Procesi i Flokulimit. Eshte procesi i bashkimit te themijave koloidale dhe atyre ne susbension.

6. Procesi Dekantimit. Eshte procesi i ndarjeve se themijave te ngurta si pasoje e forces gravitacionale.

7. Procesi i Filtrimit. Eshte proces i cili realizon ndarjen e lengut nga trupi i ngurte, si pasoje e largimit te lengut ne nje mjedis poroz.

Teknologji dhe Inovacion

Impjanti qe perdoret per trajtimin e ujrave te zeza i cili quhet AS-VARIO

Avantazhet e AS-VARIO :

1. Qëndrueshmëri e lartë dhe efikasitet në procesin e perpunimit
2. Mundësi zgjerimi të moduleve teknologjike
3. Kosto minimale e funksionimit
4. Kërkesë minimale për sipërfaqje ndërtimi
5. Zhurmë minimale
6. Automatizim të procesit me kërkesë të ulët kualifikimi
7. Kosto e reduktuar ne investim



Pershkrimi i Impiantit AS- VARIO

Teknologjia e propozuar kombinohet reciprokisht me proceset biologjike dhe mekanike gjatë trajtimit të ujrave të zeza. Ky kombinim lejon optimizimin e efikasitetit të trajtimit në lidhje me kërkesat e energjisë. Me poshte renditen objektet teknologjike qe janë elemente perberes të impianteve AS-VARIO :

- 1- Paneli hyres ne pompe
- 2- Perpunimi mekanik paraprak
- 3- Aktivizimi me ngarkesë të ulët, zgjidhje teknologjike me proces denitrifikimi në hyrje
- 4- Rezervuari dytesor i dekantimit me formë katrore dhe rrjedhje vertikale
- 5- Pajisje për tharjen e llumit – dehidrues spiral
- 6-Matës i rrjedhjes në dalje



Llogaritjet per impiantet e AS-VARIO, bëhen

1. Në bazë të produktit specifik të ujrave të zeza
2. Produkteve të ndotjeve të ngurta
3. Vleres se parametrave sipas kërkesave më të fundit legjislative.
4. AS-VARIO është projektuar sipas standarteve për 1000, 2000, 3000, 4000 dhe 5000EP.



Teknologji me te mira te disponueshme

Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në Durrës.

Impianti i trajtimit të ujërave të zeza ka një kapacitet përpunimi prej 20 mijë metrash kub ujë në ditë, ku përmes teknologjisë bashkëkohore dhe lagunës, ujërat e zeza shndërrohen në ujëra 97 % të pastra. Investimet në fjalë konsiderohen si mjaft të rëndësishme edhe për mjedisin, pasi do t'i japë zgjidhje përfundimtare ndotjes së ujërave të detit për zonat turistike të Durrësit, nga Ura e Dajlanit deri tek Përroi i Agait.





Ujërat e zeza fillimisht do të përcillen përmes rrjetit të kanalizimeve në impiantin e Shën Vlashit. Pasi të kenë kaluar këtë proces nga ku do të përpunohen, ujërat do të derdhen në det, të pastra nëpërmjet hidrovorëve.

Ky impiant nuk do të çlirojë gazra dhe as erëra, për shkak se është ndërtuar së bashku me një sistem të përthithjes së gazrave që çlirohen nga përpunimi dhe përdorimi i tyre për gjenerimin e energjisë elektrike.



A close-up photograph of water splashing, with a large central droplet and several smaller ones around it, set against a dark background. The water is bright blue and white, creating a dynamic and fresh visual.

Teknologji me te mira te disponueshme

Ky proces do të mundësojë grumbullimin e ujërave të zeza të objekteve të ndërtuara në zonën turistike, për t'u dërguar në impiantin e përpunimit ku pasi të përpunohen, do të derdhen në det, por këtë radhë uji është i pastër. Shtrirja e rrjetit të mbledhjes së ujërave të zeza ka qenë i domosdoshëm dhe emergjent, sidomos në zonën turistike të Golemit, Pishat e Buta, Mali i Robit, Shkëmbi i Kavajës e në Plazh, ku ujërat e zeza vërshonin në det. Gjithashtu ky impiant perthith edhe biogazin që lirohet në fazat të ndryshme të përpunimit dhe prodhon energji elektrike të mjaftueshme për të mbuluar 30 % të nevojave të veta.

Ky impiant ka pasur një kosto prej 11.5 milion euro por trajton ujërat e një popullsie prej më shumë se 250 mijë banorësh.

Sygjerohet që impiante të tilla të aplikohen edhe në qytete të tjera të vendit,

ME TRAJTIMIN E UJIT GEZOJME SHENDET DHE MJEDIS ME TE PASTER

